



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 23.16.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË
MEDIAVE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Qershor 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi pasqyrat vjetore financiare të Komisionit të Pavarur për Media në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Valbon Bytyqi, i mbështetur nga Enver Boqolli, (Udhëheqës Ekipi) dhe Arta Birinxhiku anëtare.

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|----|
| Përmbledhje e përgjithshme | 4 |
| 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia | 6 |
| 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm | 7 |
| 3 Rekomandimet e vitit paraprak | 9 |
| 4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli | 10 |
| Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP | 18 |
| Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak..... | 21 |

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Kryetarin e Komisionit dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2013 ishte ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të Sektorit Publik të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja jonë është përcaktuar në Memorandumin e Planifikimit të auditimit të datës 22 tetor 2013.

Auditimi ynë fokusohet në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për pasqyra vjetore financiare të theksuara në memon e planifikimit të auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Komisionit të Pavarur të Mediave (duke përfshirë ekzekutimin e buxhetit dhe auditimin e brendshëm).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar).

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Komisioni i Pavarur për Media, kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Kontrollat efektive kanë siguruar që menaxhimi i buxhetit të behët në pajtueshmëri me parimet e mirëfillta të menaxhimit financiar. Kjo ka siguruar që buxheti të ekzekutohet në pajtueshmëri të plotë me planin e rrjedhjes së parasë. Derisa, të të hyrat kishin rritje në 55% në raport me vitin e kaluar.

Me tutje, prokurimi i cili vazhdimisht cilësohet si fushë me rrezik të lartë ishte zhvilluar në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik. Kontrollat efektive vërehen edhe të menaxhimi i të pasurive dhe obligimeve.

Më gjithë progresin e arritur, ne vërejtëm disa fusha në të cilat nevojiten kontrollat shtesë. Rregullorja e Komisionit të Pavarur të Mediave kishte nevojë për plotësime në lidhje me nivelin dhe mënyrën e pagesës së taksës së licencës për shërbimet mediale audio-vizuale. Ndërsa nga aspekti i rëndësisë më të ulët, kontrollat shtesë nevojiten edhe të procesi i certifikimit të pagesave.

Ne do ta përcjellim rezultatin e arritur gjatë auditimit të ri të cilin do ta fillojmë në muajin shtator të këtij viti.

Rekomandimet tona kryesore janë si në vijim:

Kryetari i Komisionit të Pavarur për Media duhet të sigurojë se:

- Proceset e filluara rreth ndryshim/plotësim rregullores ekzistuese të japin rezultate konkrete, duke bërë këtë rregullore më të qartë dhe më të lehtë në zbatim; dhe
- Ka harmonizuar numrin e të punësuarve në listën e pagave me numrin e stafit të lejuar me ligjin e ndarjeve buxhetore.

Përgjigja e Menaxhmentit - auditimi 2013

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do ti adresojnë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) të përgatisë pasqyrat vjetore financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallen deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do ti raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

KPM, ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar¹

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale **(ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar)**.

¹ Termi „opinion i pamodifikuar“ është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar“ i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (ISSAI 200). Për më shumë informacion referohu në shtojcën I.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

PVF-të duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF - Nr 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 dhe ndryshim plotësimet e tij; dhe
- Kërkesat e rregullores 01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike dhe rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare të organizatave buxhetore.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto kërkesa.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat tjera për raportim të jashtëm

Përshkrimi

Përveç hartimit të PVF-ve, nga KPM kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesat Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raportet operative vjetore (të përformancës);
- Draft Plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë;
- Raportet mbi borxhet e dorëzuara në Ministrinë e Financave (MF);
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit;
- Planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve; dhe
- Inventarizimin dhe regjistrimin e pasurive në pronësi të KPM-së.

Ne nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto kërkesa.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se KPM ka treguar gatishmëri të plotë për të adresuar të gjitha rekomandimet tona të dhëna në raportin e auditimit për vitin 2012. Janë ndërmarrë shumë veprime për t'i adresuar shqetësimet e ngritura. Ne e inkurajojmë menaxhmentin që të merr masat dhe veprimet e duhura për t'i adresuar edhe rekomandimet e këtij viti.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2012 të KPM-së ka rezultuar më 11 rekomandime kryesore. KPM, ka përgatitur një Plan Veprimi duke theksuar se të gjitha rekomandimet do të adresohen.

Në auditimin e PVF-ve për vitin 2013, ne vërejtëm se KPM kishte arritur të adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe të rezultateve nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky nivel, për shembull, mund të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrollet operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm.

Menaxhmenti i KPM-së kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Kontrollet efektive kanë siguruar që menaxhimi i buxhetit të behët në pajtueshmëri të plotë me parimet e mirëfillta të menaxhimit financiar.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për KPM-në dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €).

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2013 Realizimi | 2012 Realizimi | 2011 Realizimi |
|-----------------------------|-------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| Burimet e Fondeve: | 789,539 | 834,863 | 752,987 | 668,403 | 626,501 |
| Granti i Qeverisë -Buxheti | 789,539 | 789,539 | 707,664 | 428,015 | 488,213 |
| Të hyrat vetjake të bartura | 0 | 45,324 | 45,323 | 240,388 | 138,288 |

Nga të dhënat e prezantuara në tabelë, shihet se mes të buxhetit fillestar dhe final të KPM-së nuk kishte ndryshime të dukshme, përveç alokimit të të hyrave të bartura nga viti 2012, të inkasuara përmes taksave të licencimit të operatoreve që ofrojnë shërbime mediale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €).

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final ² | 2013 Realizimi | 2012 Realizimi | 2011 Realizimi |
|---|-------------------|----------------------------|----------------|----------------|----------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike: | 789,539 | 834,863 | 752,987 | 668,403 | 626,501 |
| Pagat dhe Mëditjet | 373,769 | 373,769 | 296,475 | 232,619 | 224,456 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 395,770 | 431,094 | 430,097 | 418,804 | 375,430 |
| Komunalit | 20,000 | 20,000 | 17,086 | 16,980 | 18,495 |
| Investimet Kapitale | | 10,000 | 9,329 | | 8,120 |

Gjatë vitit 2013, KPM kishin shfrytëzuar 752,987€ ose 90.2% të buxhetit final. Realizimi i mirë i buxhetit vërehet në të gjitha kategoritë ekonomike, më përjashtim të kategorisë paga dhe mëditje, i cili ishte më i ulët në 79%.

Kjo ishte shkaktuar nga lëvizjet e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media dhe Anëtarëve të Bordit për Ankesa të cilëve ju ka kaluar mandati, andaj deri në rrimërimin e tyre nga Kuvendi i Kosovës kanë kaluar disa muaj.

Tabela 3. Të hyrat e inkuara për buxhetin e Kosovës - realizimi ndaj buxhetit (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2013 Pranimet | 2012 Pranimet | 2011 Pranimet |
|---|-------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| Të hyrat nga licenca të radios dhe televizionit | - | - | 312,501 | 214,536 | 256,334 |
| Të hyrat nga gjobat | - | - | 74,247 | 4,667 | 50,000 |
| Të hyrat nga denimet për media | - | - | 15,225 | 2,088 | 0 |
| Totali | 286,361 | 286,361 | 401,972 | 221,290 | 306,334 |

Gjatë vitit 2013, KPM kishte inkasim të mirë të të hyrave. Plani i të hyrave ishte tejkaluar për 40%. Krahasuar me vitin 2012, të hyrat ishin rritur për 55% si rezultat i mbledhjes së borxheve nga vitet paraprake.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

² Buxheti Final- buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

4.3 Të hyrat

Përshkrimi

Të hyrat e inkasuara nga KPM-së gjatë vitit 2013 ishin në vlerë 401,972€. Këto janë mbledhur nga tri (3) burime, si: licencat e radiove dhe televizioneve 312,501€, gjobat 74,247€ dhe dënimet për media 15,225€.

KPM-ja ka një gamë kontrollesh që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave, duke përfshirë edhe prezantimin e tyre në PVF. Megjithatë, disa procese kanë nevojë të përmirësohen për ta mbështetur saktësinë dhe plotësinë e mbledhjes së të hyrave.

Çështja 1 - Paqartësi në Rregulloren e KPM-së për menaxhimin e të hyrave nga taksat e licencës për shërbimet mediale audio-vizual – Prioritet i lartë

E gjetura Ne i trajtuam edhe të hyrat nga tarifat e licencimit të operatoreve të shërbimeve mediale. Rregullorja KKPM-2010/02 e nxjerrë me 15.12.2010 e trajton nivelin dhe mënyrën e pagesës së taksës së licencës. Kjo rregullore mund të rishikohet çdo dy vite. Në kuadër të rishikimit mund të ndryshojnë edhe tarifat e licencave. Në vijim kemi prezantuar disa pika të cilat ka nevojë të shqyrtohen:

- Neni 3.1 paragrafi a) “Vlerës bazë të shprehur (A) – e llogaritur në bazë të buxhetit të përgjithshëm vjetor e pjesëtuar me numrin e subjekteve të licencuara transmetuese tokësore, numrin e ditëve të vitit dhe me 24 orë”. Kalkulimi i tarifave të përcaktuara në këtë rregullore ishte shumë të komplikuar; dhe
- Neni 5.7. “Mospagimi i taksës së licencës, do të rezultojë në sanksionimin e subjektit transmetues, në pajtim me Ligjin dhe rregulloret e KPM-së. Sanksionimi mund të rezultojë edhe me revokimin e licencës”. Ne, nuk vërejtëm se janë të përcaktuara afatet kohore lidhur llojin e masës sanksionuese përkatëse për mos pagesën e taksës së licencës me kohë.

Në memorandumin e auditimit të ndërmjetëm, të dorëzuar në muajin dhjetor 2013, ne këshilluam KPM-në që ta rishikojë këtë rregullore. Pas kësaj, KPM-ja menjëherë ka ndërmarr veprimet e nevojshme dhe tani është në proces të plotësimit të saj.

Rreziku Në mungesë të bazës së qartë rregullative mund të shkaktohen paqartësi në zbatimin e procedurave, si dhe të krijohen rrethana në të cilat nuk trajtohen njëjtë të gjithë operatorët që ofrojnë shërbime të ngjashme.

Rekomandimi 1 Kryetari i Komisionit duhet të siguroj se proceset e filluara rreth ndryshim/plotësim rregullores ekzistuese të përfundohen, duke ë bërë këtë rregullore më të qartë dhe me të lehtë në zbatim.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Sipas regjistrit të kontratave të nënshkuara për vitin 2013, shohim se KPM kishte nënshkuar 30 kontrata. Ne kemi testuar shtatë (7) kontrata nga lista e kontratave të nënshkuara, duke përfshirë kontratat me vlera me të larta duke përfaqësuar 80% të vlerës së kontratave që ka nënshkuar KPM-ja në vitin 2013.

Ne rishikuar procesin e blerjeve përmes prokurimit për të vlerësuar nëse KPM ka zbatuar procedurat dhe i është përmbajtur dispozitave të ligjit të prokurimit publik.

Bazuar në këtë ne identifikuar çështjen në vijim.

Çështja 2 - Urdhërblertjet plotësohet pas raportit të pranimit - Prioritet i mesëm

E gjetura Rregulla financiare nr. 01/2013/MF shpenzimi i parave publike përcakton procedurat e përgjithshme për procesimin e pagesave. Fillimisht duhet të lëshohet urdhërblertja, e pas pranimit të blerjeve behet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura.

Për procesimin e disa pagesave nuk janë respektuar rregullat e thesarit. Urdhërblertjet ishin bërë më vonesë, përkatësisht pas raportit të pranimit dhe faturës. Gjithashtu raportet e pranimit nuk përshkruanin mirë llojet dhe sasisë e mallrave të pranuar.

Rreziku Kryerja e procedurave për pagesë para se të përcaktohen kërkesat/nevojat, mund të rezultojë që të pranohen mallra/shërbime të sasisë jo të nevojshme, ose ato të jenë të kualitetit të dobët.

Rekomandimi 2 Kryetari i Komisionit duhet të siguroj kontrollë funksionale gjatë procesit të ekzekutimit të pagesave. Të gjitha format e kërkuara me rregulla të thesarit, duhet të plotësohen në mënyrë të qartë dhe kronologjike.

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrimi

Në kategorinë e shpenzimeve tjera për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit, ne testuam disa mostra, që përfshijnë avancet e udhëtimeve jashtë vendit, shpenzimet e telefonit, shpenzimet e tjera kontraktuese si dhe shpenzimet e realizuara nga paraja e imët (pety cash).

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Shpenzimet e pagave dhe mëditjeve për vitin 2013 ishin në vlerë prej 296,475€.

Ne kemi rishikuar listat e pagave si dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PVF. Po ashtu kemi testuar mostra, duke përfshirë dosjet e personelit dhe procedurat e rekrutimit të realizuara gjatë vitit 2013. Bazuar në këtë, ne kemi konstatuar së KPM ka vendosur sisteme të mira të kontrollit mbi fushën e kompensimeve (pagave dhe mëditjeve) dhe të rekrutimit, me përjashtim të çështjes në vijim.

Çështja 3 - Numri i të punësuarve në listën e pagave me i larte se ai në buxhetin vjetor - Prioritet i lartë

- E gjetura** Sipas Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, "Asnjë organizatë buxhetore nuk mund të tejkalojë numrin total të pozitive të punës në asnjë kohë gjatë vitit fiskal 2013.
- KPM, me buxhet i kishte të aprovuara 31 pozita, ndërsa në listat e pagave është tejkualuar ky numër (në muajin janar ishin 35 të punësuar, ndërsa pas rekrutimeve në muajin dhjetor ishin 39 të punësuar³). KPM ka bërë kërkesa të vazhdueshme që nga viti 2011 për ti rritur numrin e pozitive të punës, mirëpo kjo nuk ishte aprovuar nga komisioni për buxhet dhe financa.
- Rreziku** Rritja e numrit të të punësuarve pa aprovimin e tyre më buxhet, rrit rrezikun që një numër i stafit të mbetet pa kompensimet e duhura.
- Rekomandimi 3** Kryetari i Komisionit duhet të siguroj se ka harmonizuar numrin e të punësuarve në listën e pagave me numrin e stafit të lejuar me ligjin e ndarjeve buxhetore.

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrimi

Sipas regjistrimit kontabël (SIMFK) lista e pasurive të KPM-së përmban një vlerë neto prej 858,821€, ndërsa pasuria jo-kapitale me vlerë nën 1000€ është 38,037€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore. Gjithashtu, ne kemi verifikuar nëse ekziston fizikisht pasuria e evidentuar në regjistrat e pasurisë.

Ne konstatojmë se KPM kishte menaxhuar pasuritë e veta në përputhje me praktikën e mira menaxheriale dhe me kornizën ligjore në fuqi. Zyrtari i pasurive ka bërë azhurnimin e

³ KPM, në njërin anë kishte buxhet të pashfrytëzuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve, ndërsa në anën tjetër kishte tejkualime të numrit të të punësuarve. Buxheti i pashfrytëzuar ishte si rrjedhojë e lëvizjeve të anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media dhe Anëtarëve të Bordit për Ankesa të cilëve ju ka kaluar mandati. Mungesa e tyre deri në riemërimin e tyre nga Kuvendi i Kosovës ka shkaktuar suficit në këtë kategori.

vazhdueshëm të pasurisë, andaj posedon një regjistër të plotë dhe të saktë lidhur me pasurinë që disponon.

Inventari që posedon KPM është i pajisur me bar-kode përkatëse, duke ngarkuar secilin zyrtarë që e posedon në shfrytëzim. Në fund të vitit ishte kryer edhe inventarizimi i pasurisë.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrimi

Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në PVF, ishin 307,773€. Prej tyre 186,520€ rrjedhin nga vitet paraprake, ndërsa 121,253€ janë nga viti 2013.

Në memon e auditimit, ne këshilluam menaxhmentin e KPM-së që të marrë të gjitha masat e përcaktuara me Ligjin e KPM-së ndaj operatoreve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

Menaxhmenti i KPM-së ka adresuar këshillën tonë dhe ka marrë veprime duke arkëtuar një shumë të konsiderueshme të të arkëtueshmeve. Ata kanë iniciuar procedura gjyqësore pranë gjykatës kompetente për një numër të klientëve që nuk i kanë përmbushur obligimet.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5.3 Trajtimi i borxheve

Përshkrimi

KPM në vitin 2013 ka raportuar obligime të papaguara në pajtim me kërkesat e rregullores financiare nr. 02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore dhe në pajtim me rregulloren MF - Nr 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore.

Pasqyra e obligimeve të papaguara të KPM-së ndaj furnitorëve në fund të vitit 2013 ishte në shumë prej 8,675€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2014.

Ne gjithashtu kemi rishikuar nëse obligimet e mbetura në fund të vitit 2013 janë paguar në fillim të vitit 2014. Ne vërejtëm se këto obligimet janë paguar në fillim të këtij viti.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

KPM ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NJAB) dhe ka të punësuar një auditor (njëkohësisht udhëheqës i njësisë). Kjo njësi ka përgatitur planin strategjik dhe planin vjetor të auditimit. Në planin vjetor kishte planifikuar të kryej gjashtë (6) auditime, përfshirë fushat me rrezik më të lartë. Gjatë vitit 2013, kjo njësi kishte realizuar në tërësi planin e auditimeve, përkatësisht kishte përfunduar gjashtë (6) raporte të auditimit. Njëkohësisht udhëheqësi i NJAB-së është duke i ndjekur trajnimet për licencim si auditor i brendshëm.

Ne i kemi analizuar këto raporte dhe konstatojmë se janë të cilësisë së duhur. Në to janë dhënë konkluzione dhe rekomandime të dobishme që mund ti ndihmojnë menaxhmentit të KPM-së.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

| Komponenta e Auditimit | Rekomandimet e dhëna | Rekomandimet plotësisht të adresuara | Rekomandimet pjesërisht të adresuara | Rekomandimet e pa adresuara |
|---|--|--------------------------------------|--------------------------------------|-----------------------------|
| 2.2. Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në PVF | Të siguroj se pagat e stafit paguhen vetëm nga buxheti i dedikuar për Paga. | Po | | |
| 2.2. Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në PVF | Shpalosjen e plotë të pasurive kontigjente në PVF si dhe përshkrimi i gjendjes së tyre. | Po | | |
| 4.3. Kërkesat e raportimit | Pasqyrat nëntëmujore Financiare e ardhshme të përgatiten në pajtim me kërkesat ligjore për raportim financiar | Po | | |
| 4.3. Kërkesat e raportimit | Kryerjen e procesit të vetëvlerësimit duke e konsideruar si pjesë e përpjekjeve të veta në drejtim të zhvillimit të mëtutjeshëm të sistemeve, proceseve dhe aktiviteteve aktuale të organizatës. | Po | | |
| 4.5.1. Prokurimi | Të siguroj një analizë të kostos dhe benefitit të mbushjes elektronike kundrejt mbushjes me kartela për të gjetur një zgjidhje më optimale për shërbimet telefonike. | Po | | |

| | | | | |
|--|---|----|--|--|
| 4.5.1. Prokurimi | Të forcoj kontrollet e brendshme në fushat me mangësi të identifikuar për të siguruar kryerjen e aktiviteteve operative të rregullta, efikase dhe efektive si dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. | Po | | |
| 4.5.1. Prokurimi | Të shtohen kontrollet në sektorin e pagesave për të siguruar shfrytëzimin e të gjitha alternativave ligjore për procesimin e pagesave nga kategoria dhe kodet ekonomike adekuate. | Po | | |
| 4.5.2. Shpenzimet tjera | Të siguroj se kompenzimi i stafit bëhet në përputhje me kornizën rregullative në fuqi, si dhe të evitoj kompenzimin shtesë për detyrat e rregullta të punës të kryera gjatë orarit. | Po | | |
| 4.5.2. Shpenzimet tjera | KPM duhet të siguroj që pavarësisht numrit të seancave të mbajtura të respektoj limitet e lartësisë së kompenzimit të anëtarëve të komisionit të përcaktuara në udhëzimet në fuqi. | Po | | |
| 4.5.3. Kompensimet (pagat dhe mëditjet | Për pozitat menaxhuese të caktohen punëtorët me kualifikime dhe kompetenca të përshtatshme me përshkrimin e vendit të punës. | Po | | |
| 4.6.2. Trajtimi i parasë së gatshme | Të forcoj kontrollet në menaxhimin e parasë së gatshme duke aprovuar vetëm pagesat e paplanifikuara dhe urgjente. | Po | | |